



## **SYLLABUS I LËNDËS: LETËRSI POPULLORE**

<b>Të dhëna bazike të lëndës:</b>	
<b>Universiteti:</b>	Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti i Filologjisë
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Letërsi popullore</b>
<b>Programi:</b>	Gjuhë dhe letërsi shqipe
<b>Niveli:</b>	Baçellor
<b>Statusi lëndës:</b>	Obligative (O)
<b>Viti i studimeve:</b>	Viti I, Semestri I
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2 +1
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	4
<b>Koha / lokacioni:</b>	Semestri dimëror
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. ass. dr. Manjola Brahaj Halili</b>
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	<a href="mailto:manjola.brahaj@uni-prizren.com">manjola.brahaj@uni-prizren.com</a>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p>Programi i kësaj lënde parasheh letërsinë popullore të botuar që nga fillimet (1736) e deri më sot. Në programin e kësaj lënde përfshihet letërsia popullore (gojore) sipas zhanreve duke filluar nga këngët ritualistike të motmotit dhe familjare, këngët lirike të dashurisë, të gjitha modelet e epikës gojore, baladat popullore, legjendat dhe këngët historike, si dhe prozën popullore shqiptare të seleksionuar sipas zhanreve. Në fillim do të trajtohet e gjithë struktura artistike e tregimeve gojore legjendare, të përrallave, gojedhënave dhe legjendave në prozë, për të vazhduar më tutje me botën e prozës realiste siç janë: tregimet novelistike, kallëzimet, dhe tregimet humoriatike, përkatësisht anekdotat e gjëgjëzat. Programi do të përmbajë njohuri dhe informacione të plota dhe të thelluara në lidhje me mbledhjen e folklorit, studimin, llojet e tij, rolin dhe rëndësinë që ka në zhvillimin e letërsisë së kultivuar, si dhe autorët më të rëndësishëm që kanë kontribuar në lindjen dhe zhvillimin e folkloristikës shqiptare.</p>
<b>Qëllimi i lëndës:</b>	<p>Qëllimi i këtij kursi është që studentët të përvetësojnë e zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për mbledhjen, studimin dhe rolin e letërsisë popullore në zhvillimin dhe kuptimin e letërsisë në përgjithësi. Në mënyrë të veçantë studentët do të mund të lexojnë, komentojnë, analizojnë dhe interpretojnë tekste e vepra të kësaj letërsie, gjëgjësisht, këngë epike e legjenda, këngë historike, këngë të dashurisë, këngë dasmash, ninulla, vaje, anekdoda, gjëgjeza etj. Ky kurs ka për qëllim gjithashtu që të pajisë studentët me njohuritë kryesore dhe më të rëndësishme të kësaj letërsie, si baza e zhvillimit dhe avancimit të letërsisë së kultivuar.</p>



<b>Rezultatet e të nxënit:</b>	<p>Gjatë dhe pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njohin letërsinë popullore shqiptare;</li> <li>• komentojnë rreth rolit të saj si krijimtari letrare;</li> <li>• analizojnë vlerat artistike të kësaj letërsie;</li> <li>• interpretojnë dhe analizojnë ndërtimin, strukturën dhe idetë e veprave të ndryshme të letërsisë popullore;</li> <li>• njohuritë e fituara t'i zbatojnë në praktikë në veprimtaritë e tyre profesionale;</li> </ul>		
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Kollokfiume, seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	2	1	2
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	2	2	4
Projektet, prezantimet ,etj	1	7	7
<b>Totali</b>			<b>100 orë (4 ECTS)</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p>Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave, ushtrimeve, debateve dhe seminareve me metodat bashkëkohore. Do përdoren edhe punë me grupe, punë dyshe, diskutime rreth teorive, analiza praktike tekstesh etj Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit 45 % 55 %.</p>		
<b>Metodologjia e vlerësimit:</b>	<p>Vlerësimi i studentëve bazohet në punën, aktivizimin, frekuentimin, kolekviumet dhe punimin e prezantuar në përmbyllje të semestrit.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Testi i parë: 1-40%</li> <li>2. Testi i dytë: 1-40 %</li> <li>3. Prezantimet studentore – 10 %,</li> <li>4. Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 10%</li> <li>5. Totali: 100 %</li> </ol> <p>(Vlerësimi në pikë:</p>		

	01-50= 5, 51-60 = 6, 61-70 = 7, 71-80 = 8, 81-90 = 9, 91-100=10
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura primare:</b>	Gjergj Zhej: Folklori shqiptar, SHBLU, Tiranë 2004. Demush Shala: Letërsia popullore, Prishtinë 1988.
<b>Literatura shtesë:</b>	Agron Xhagolli: Klasifikimi i prozës popullore, Tiranë, 2001. Anton Çetta: Kërkime folklorike, Prishtinë, 1981. Qemal Haxhihasani: Hyrje,në:Epika legjendare (Cikli i kreshnikëve),Tiranë 1966. Shaban Sinani: Mitologji në eposin e kreshnikëve, Argeta LMG, Tiranë 2000. Muzafere Mustafa: Proza gojore – Teksti dhe konteksti, Prishtinë, 2005. Gjergj Zheji: Bazat e vargëzimit shqiptarë-Vargu i këngëve kreshnike, Prishtinë 1990.

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>		
<b>Java</b>	<b>Ligjërata</b>	<b>Ushtrime</b>
<i>Java e parë:</i>	<b><i>Letërsia popullore – vështrim i përgjithshëm</i></b>	<i>Diskutime rreth përkufizimit dhe rolit të letërsisë popullore</i>
<i>Java e dytë:</i>	<b><i>Zanafilla e letërsisë popullore. Historia e folkloristikës shqiptare</i></b>	<i>Diskutime rreth folkloristikës dhe origjinës së letërsisë popullore.</i>
<i>Java e tretë:</i>	<b><i>Festat dhe këngët e motmotit. Ritet e lindjes dhe ninullat në letërsinë popullore shqipe</i></b>	<i>Diskutime për festat e motmotit dhe lexime, komente të ninullave</i>
<i>Java e katërt:</i>	<b><i>Ritet dhe këngët e dasmës . Ritet e vdekjes dhe vajet në letërsinë popullore shqipe. Këngë dashurie</i></b>	<i>Lexime dhe komentime të këngëve të dasmave dhe të vajeve të ndryshme</i>
<i>Java e pestë:</i>	<b><i>Këngët epike – vështrim i përgjithshëm.</i></b>	<i>Diskutime për këngët e dashurisë dhe tiparet e tyre dalluese</i>
<i>Java e gjashtë:</i>	<b><i>Këngët legjendare – vështrim i përgjithshëm . Legjendat; e murosjes, e vllait të vogël, e rinjohjes së burrit me gruan, të rinjohjes së vëllait me motrën dhe e vëllavrasjes.</i></b>	<i>Lexime, analiza dhe komente për këngët epike</i>
<i>Java e shtatë:</i>	<b><i>Legjenda e rinjohjes së burrit me</i></b>	<i>Lexime, diskutime dhe krahasime</i>

	<b>gruan</b> <b>Legjenda e rinjohjes së vëllait me të motrën</b> <b>Këngë kreshnike – mbi Gjergj Elez Alinë</b>	rreth legjendave dhe versioneve të tyre
Java e tetë:	<b>Testi i parë vlerësues</b>	Diskutime dhe konsultime rreth rezultateve të arritura
Java e nëntë:	<b>Këngët e epikës historike – vështrim i përgjithshëm</b> <b>Këngët e luftës së Kosovës</b> <b>Këngët për Skënderbeun</b>	Analizë dhe diskutime për këngën e luftës së Kosovës
Java e dhjetë:	<b>Epika historike popullore në shekujt XVI – XVIII:</b> <b>Këngë për principatën e bushatëve;</b> <b>Këngë të periudhës së Ali Pashë Tepelenës;</b> <b>Epika historike rreth Tanzimatit</b>	Lexime për këngët e principatave dhe të Ali Pashë Tepelenës, tipare dhe veçori dalluese
Java e njëmbëdhjetë:	<b>Epika historike e gjysmës së dytë të shekullit të XIX dhe të fillimit të shek. XX:</b> <b>Këngët e nizamëve;</b> <b>Këngët e kacakëve</b>	Lexime dhe komente rreth këngëve të kacakëve dhe nizamëve
Java e dymbëdhjetë:	<b>Përrallat</b> <b>Përrallat shqiptare</b> <b>Përrallëzat popullore</b>	Diskutime rreth përrallave, origjinës dhe rolit të tyre didaktiko – moralizues
Java e trembëdhjetë:	<b>Anekdotat</b> <b>Legjendat popullore në prozë</b>	Lexime, shembuj dhe raste të përdorimit të humorit në folklor. Lexime anekdotash
Java e katërbëdhjetë:	<b>Proverbat popullore</b> <b>Kashelashat</b>	Proverbat popullore dhe roli i tyre filozofiko – artistik
Java e pesëmbëdhjetë:	<b>Testi i dytë vlerësues</b>	Diskutime dhe konsultime rreth rezultateve të arritura

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Nuk do të ketë kurrfarë tolerime për “huazim” nga interneti apo kudo tjetër. Punimet e njejta apo të ngjajshme gjithashtu do të ndëshkohen. Rekomandohet që punimet që dorëzohen të jenë të shkruara me kompjuter.

- Studentët duhet t’u përbahen rregullave të përcaktuara sipas Statutit të UPZ-së dhe rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Senati i UPZ-së dhe këshilli mësimor.
- Pritet që secili student të vijë me kohë.
- Nga çdo student pritet që të marrë pjesë në çdo ligjeratë.



- Për shkak të natyrës dhe mënyrës së mësimit në këtë lëndë, ardhja në mësime dhe pjesëmarrja aktive në diskutim është me rëndësi të veçantë.